



Prokurimi Publik në numra gjatë vitit 2022



Prokurimi Publik në numra - rritet vlera e kontratave një burimore, KEK-u nënshkruan më së shumti kontrata


Prokurimi publik është një nga format më të rëndësishme të shpenzimit të parasë publike përmes të cilit institucionet dhe ndërmarrjet publike lidhin kontrata për furnizime, shërbime dhe punë me operatorë të ndryshëm ekonomikë.

Në Kosovë, gjatë vitit 2022, 162 autoritete kontraktuese (organizata buxhetore qeveritare dhe ndërmarrje publike) nënshkruan 10,290 kontrata publike duke u bazuar në Ligjin për Prokurim Publik apo 403 kontrata publike më shumë se në vitin 2021. Megjithatë, duke e pasur parasysh që viti 2020 dhe 2021 ishin vite kur pandemia Covid-19 pamundësoi zhvillimin e shumë aktiviteteve, krahasimi më adekuat do të ishte me vitin 2019, vit kur ishin nënshkruar 12,441 kontrata apo 2,151 më shumë se në vitin 2022.



Vlera e përgjithshme e kontratave të nënshkruara për vitin 2022 ishte 559,017,913.90 euro që paraqet 6.5% të Bruto Produktit Vendor (BPV)¹. Vlera e kontratave të nënshkruara për furnizime ishte 229,304,127.33 euro, për shërbime 81,255,690.82 euro ndërkohë për punë u nënshkruan kontrata në vlerë 247,580,673.75 euro.

Vlera e kontratave publike të nënshkruara në vitin 2022 ishte 129,395,698.10 euro më e lartë se në vitin 2021 (30.12%), por kjo vlerë vazhdon të jetë dukshëm më e ulët se në vitin 2019, i cili ishte viti i fundit para fillimit të pandemisë së COVID 19, vit në të cilin u lidhën 12,441 kontrata në vlerë 781,396,035.04 euro.



¹ Bruto Produkti Vendor (BPV) për vitin 2022 ishte 8,594,000,000.00

Vlera e kontratave të nënshkuara sipas procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës (kontratave një burimore) gjatë vitit 2022, shënoi rritje për 26,571,105.09 euro nga viti 2021, duke arritur 14%² të vlerës së përgjithshme të kontratave publike.


Shuma e kontratave të nënshkuara sipas procedurës së hapur, që është procedura më transparente e prokurimit, në vitin 2022 ishte 437,134,994.55 euro (78.20%), ndërkohë kontratat e nënshkuara me procedura tjera arritën vlerën 43,313,735.84 euro (8%).

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ishte autoriteti kontraktues që lidhi kontrata në vlerën më të lartë në vitin 2022, duke nënshkuar 505 kontrata në vlerë 43,969,189.36 euro. Prej këtyre 505 kontratave të nënshkuara, 41 prej tyre ishin një burimore dhe kapin vlerën 16,781,800.00 euro, apo gati se gjysma e buxhetit total të shpenzuar. Në mesin e 41 kontratave të lidhura mes KEK dhe operatorëve ekonomikë të ndryshëm, në tetë raste kontratat janë lidhur mbi vlerën e parashikuar e që në total vlera totale e diferencës mes vlerës së parashikuar dhe çmimi të kontratave të lidhura është 3,660,123.00 euro.

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShKUK), lidhi 320 kontrata në vlerë 35,336,922.60 euro, Komuna e Prishtinës lidhi 269 kontrata në vlerë 34,922,607.40 euro, Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) lidhi 90 kontrata në vlerë 26,446,481.32 euro, ndërsa Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), lidhi 74 kontrata në vlerë 25,517,289.12 euro.

² Vlera e kontratave të nënshkuar sipas procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë përfshinë kontratat për punët shtesë.

Autoritetet kontraktuese që nënshkruan kontratat me vlerat më të larta në vitin 2022




Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) lidhi 505 kontrata në vlerë totale 43,069,189.36 euro në vitin 2022 - më shumë se cilido autoritetet kontraktues tjetër.

Burimi: KRPP

Në vitin 2022, për një tender mesatarisht morën pjesë 4.08 operatorë ekonomikë, që shënon një rritje të vogël krahasuar me vitin 2021, ku mesatarisht ofertuan 4.0 operatorë ekonomikë.

Numri mesatar i operatorëve ekonomikë ofertues për tender në katër vitet e fundit



Në vitin 2022, numri mesatar i operatorëve ekonomikë që konkurruan për një tender ishte 4.08 - një ngritje e vogël (0,8) nga vitin 2021.

Burimi: KRPP

Burimi i të dhënave është Raporti Vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), raport i cili dorëzohet çdo vit kalendarik në Qeveri dhe Parlament. Ky raport analizon të gjitha aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë gjatë vitit kalendarik, duke ofruar rekomandime për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik.